



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

CAKTIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL SI ORGAN QENDROR BLERËS PËR REALIZIMIN
E PROCEDURËS SË PROKURIMIT ME OBJEKT “MBROJTJEN
E GËSHTENJËS NGA PARAZITI GRERËZA GALEFORMUESE
DRYOCOSMUS KURIPHILUS HYMENOPTERA CYNIPIDAE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; nenit 53 të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”; ligjin nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”; me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si organ qendror blerës për realizimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (*Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae*)”.
2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ngarkohet për lidhjen e kontratës objekt prokurimi dhe monitorimin e zbatimit të kontratës.
3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit së bashku me Agjencinë Kombëtare e Pyjeve(AKP), në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe me njësitë e Vetqeverisjes Vendore/Bashkitë, monitoron respektimin e kërkesave teknike trajtuese të vendosura në zbatim të këtij procesi.
4. Fondi për procedurën e prokurimit publik të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2022, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpenzimet

korrente në programin buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” produkti “Sipërfaqe e trajtuar dhe e mbrojtur nga parazitët në fushën e bujqësisë”.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve(AKP) si dhe njësitë e Vetqeverisjes Vendore/Bashkitë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA